



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.28/2018

Prishtinë, më 20 korrik 2018

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Sasha Milosavljeviq, Saranda Bogujevci, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Fisnik Ismaili.

Munguan: Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Shemsi Syla, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Jahja Lluka-ZKM, Prenk Gjetaj-ZKM-KQPZH, Kushtrim Gara-ZKM-KQPZH, Blerina Krasniqi-KDI, Emine Shehu-Zyra për Informim-Kuvendi, Teuta Prekazi-UN, Visar Bivolaku-EUO dhe Ardita Sylejmani-RTK.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë.

**Rend dite:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Diskutim në komision lidhur me çështjen e Personave të Pagjetur pas samitit të mbajtur në Londër. Të ftuar: Përfaqësues të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur;
3. Takim në Komisionin Funkcional me grupin e studentëve nga Italia dhe përfaqësues të KFOR-it Italian:

4. Të ndryshme.

\*\*\*

## **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur me 21 qershor 2018, nuk u hodh në votim pasi që nuk kishte kuorum.

## **2. Diskutim në komision lidhur me çështjen e Personave të Pagjetur pas samitit të mbajtur në Londër. Të ftuar: Përfaqësues të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur.**

**Kryetarja** tha se edhe pse nuk kemi kuorum të mjaftueshëm ne do t'i dëgjojmë të ftuarit nga Komisioni Qeveritar lidhur me atë se çka është diskutuar në Samitin e Londrës për çështjen e të pagjeturve.

**Jahja Lluka** tha se në Samitin e Londrës një ndër pikat më të rëndësishme ka qenë çështja e personave të zhdukur, ku përveç kryeministrave ka qenë edhe një takim i komisioneve rajonale ku kanë qenë të gjitha shtete që kanë dalë nga ish- Jugosllavia dhe për herë të parë Kosova në Samitin e Londrës ka qenë e barabarte me të gjitha shtetet. Në takimin me komisionet rajonale është paraqitur një plan nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar dhe të ICMP-së i cili fatkeqësisht nuk është nënshkruar për shkak se Kroacia ka insistuar se i ka kryer detyrat e veta dhe tani është pjesë e Unionit Evropian dhe nuk ka dashur të jetë pjesë në nivel të njëjtë me shtetet e tjera të rajonit. Serbia ka insistuar ose me qenë pjesë të gjithë ose jo, por e rëndësishmja është se përfaqësuesit e Kroacisë planin e kanë aprovua dhe janë zotuar se do ta implementojnë dhe të gjithë kryeministrat që kanë marrë pjesë në Samitin e Londrës e kanë nënshkruar pikën e veçantë për ndriçimin e fatit të personave të zhdukur në rajon.

Dihet se diku rreth 40 mijë persona kanë qenë të zhdukur nga luftërat e viteve të 90-ta, në ish- Jugosllavi, dhe se 70% nga ky numër janë zbardhur. Nuk dihet edhe për 12 mijë persona, ndërsa, ne si Kosovë kërkojmë 1650 njerëz tanë. Ky plan parasheh edhe krijimin e një grupi të veçantë rajonal i cili ka marrë njëfarë emri Grupi i Londrës, dhe shpresojë që kjo është një dritë në fund të tunelit për ta përsheptuar gjetjen e njerëzve tonë të cilët janë të zhdukur. Në këtë Samit një fjalim të veçantë e ka pasur edhe Princi Charls dhe ishte shumë prekës fjalimi i tij. Obligohen shtetet e rajonit që të gjitha informatat që i kanë t'i bëjnë transparente dhe që t'u jepen shteteve përkatëse të cilat i kërkojnë.

Në vazhdim, ai njoftoi anëtarët e Komisionit se është formuar grupi punues për hartimin e koncept dokumentit për Projektligjin për personat e zhdukur, dhe tha se beson që shumë shpejt do ta procedojmë për qeveri dhe në Kuvend.

**Kryetarja** pyeti se çfarë ndryshime priten mbas takimit të Samitit të Londrës ku u tha se është dhënë drita e gjelbër për dhënie të informatave, dhe se tani Serbia është e obliguar t'i japë informatat për personat e zhdukur dhe vendet e rajonit janë të obliguara të japin informatat për çka kemi nevojë.

**Jahja Lluka** tha se në bazë të nënshkrimeve e kanë obligim të gjitha shtetet me dhënë informacion, se a do t'i përmbahet Serbia marrëveshjes tha se është pak skeptik, por shpreson se presioni i liderëve të gjithë Evropës të cilët ishin prezent do ta ketë ndikimin e vet.

**Luljeta Veselaj -Gutaj** tha se Samiti i Londrës është një hap i mirë për Kosovën dhe shpresojë shumë se Serbia duhej të përgjigjej për krimet dhe gjenocidin të cilin e ka bërë në Kosovë, është momenti që nënshkrimet të cilat jepen në Samitet e tilla, siç ka qenë edhe ky i Londrës, nuk duhet të mbesin vetëm nënshkrime në letër por të sjellin veprime konkrete sepse Serbia i ka shumë borxh Kosovës dhe të gjithë duhet ta kemi fokusin që ta zbardhim fatin e të gjithë atyre personave që ende nuk i dimë se ku janë. Më pas, ajo bëri pyetje se çka shiheni prapa këtij Samiti konkretisht, cilët janë hapat e parë që do të ndërmerren, dhe a do të përfshihet kjo temë në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

**Fisnik Ismaili** u interesua të dijë se a është bërë ndonjë plan i veprimit dhe a është caktuar ndonjë datë se kur pritet të ndodhin hapat e parë, për të parë se si po zbatohet ajo marrëveshje. U tha se janë stagnuar 16 kallëzime penale dhe a ka ndonjë arsye pse janë kaq pak dhe përse janë ndaluar dhe përse janë vonuar urdhëresat për hulumtimin e rasteve.

**Kryetarja** u tha se është formuar një grup i veçantë rajonal, a është caktuar përfaqësuesi i Kosovës në këtë grup?

**Jahja Lluka** tha se plani i veprimit është paraqitur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar dhe të ICMP-së, dhe nuk është nënshkruar nga Kroacia, por kryeministri i Kroacisë e nënshkruan deklaratën e Samitit. Grupi nuk është themeluar pasi nuk është nënshkruar plani i veprimit i cili i ka edhe datat. Javën e ardhshme besoj se do të arrijmë të bëhemi edhe anëtarë të ICMP-së dhe jemi zotuar që planin do ta implementojmë, do të jemi anëtarë të grupit të Londrës i cili do të themelohet dhe se Kosova do ta ketë përfaqësuesin e vet.

Sa i përket dialogut tha se nuk ka mundësi mos me hy kjo çështje në dialog, sepse pa zbardhjen e fatit të këtyre njerëzve nuk do të ketë qetësi as në Kosovë e as në Serbi. Ndërsa, sa i përket hetimeve tha se kemi bërë presion edhe te prokurorja se duhet të bëhet publike gjithçka sepse po insistojmë që të respektohet ligji dhe afatet ligjore ka disa raste që janë zgjidhur, por ka arsyetime se ka mungesë të prokurorëve. Ai tha se ka shkelje të ligjit por ligji duhet të respektohet njëjtë si për shqiptarët si për serbët, tha se komuna e Graçanicës po bënë shkelje sepse ato familje që kanë persona të zhdukur nuk janë të liruar nga faturat e energjisë elektrike.

**Prenk Gjetaj** tha se lidhur me rastet e familjarëve të të zhdukurve, që kanë mbetur pa dhuruar gjak, kemi raste të manipulimeve nga shume njerëz të cilët ndikojnë te familjet dhe shpreson se i ka familjarët gjallë dhe ekziston mundësia që ato mbetje mortore pikërisht të jenë të familjarëve të tyre. Por, deri sa nuk ka mostër krahasuese, nuk mund të dihet identiteti i saktë. Arsyet e kësaj mund të jenë të ndryshme, mundet me qenë mashtrimi, por edhe elementi psiko-fizikë që vërtet nuk do në asnjë mënyrë me u pajtuar me realitetin sepse do me jetuar me një ëndërr se familjarët e tij janë gjallë. Urdhëresat mbështeten në informacione që organet kompetente ose policia për krime lufte, që mbledh informata dhe në bazë të informacioneve të besueshme dhe të argumentuara bën kërkesën për urdhëresë gjyqësore, mirëpo mund të jetë që edhe ajo urdhëresë tani duhet të zbatohet nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, në Institutin e Mjekësisë Ligjore deri me tani ka udhëheqë EULEX dhe ka pasur edhe zvarritje.

**Kryetarja** falënderoj përfaqësuesit e Komisionit Qeveritare për Persona të Zhdukur lidhur me informacionet që paraqiten para anëtarëve të komisionit.

### **3. Takim në Komisionin Funkcional me grupin e studentëve nga Italia dhe përfaqësues të KFOR-it Italian**

Anëtarët e Komisionit priten në takim grupin e studentëve nga Italia dhe përfaqësues të KFOR-it Italian, ku nga kryetarja dhe anëtarët e komisionit studentët u njoftuan lidhur me përbërjen dhe fushëveprimin e këtij komisioni dhe të Kuvendit në përgjithësi. Për sfidat me të cilat po ballafaqohet Kosova dhe punët që po bëhen për t'i tejkaluar këto sfida, ndërsa studentët u interesuan lidhur me punët që bën Komisioni Funkcional dhe për procedurat legjislative në Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu, ata u interesuan të dinë më shumë rreth gjendjes së procesit integruar të Republikës së Kosovës në Institucionet e BE-së, për zhvillimin ekonomik të Kosovës, si dhe për shumë çështje të tjera.

Në interesimet dhe pyetjet e studentëve nga Italia u përgjigjën anëtarët e komisionit.

Pas takimit me anëtarët e komisionit grupi i studenteve nga Italia të shoqëruar nga deputetja Saranda Bogujevci, vizituan edhe sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetarja e komisionit,

---

Duda Balje